

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: “Sigurimi i pronës për disa objekte të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare”

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 26 Korrik 2021, ora 10:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

## **UNIVERSITETI I TIRANËS FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS** **Njoftim për vend të lire pune**

Fakulteti i Shkencave të Natyrës i Universitetit të Tiranës, shpall konkursin për 1 (një) vend të lire pune për personel ndihmës akademik me karakter mësimor (laborant) pranë Qendrës Kërkimore të Florës dhe Faunës.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët që do të konkurrojnë për këtë vend pune janë si më poshtë:

### Kritere te përgjithshme:

1. Të ketë diplomë universitare Bachelor në Biologji.
2. Të ketë diplomë Master Shkencor në Biologji Mjedisore ose Diplomë e Integruar e Nivelit të dytë (DIND) në Biologji-Kimi.
3. Të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar.
4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje.
5. Të mos jetë marrë ndaj saj/tij masa disiplinore e largimit nga puna.

### Kritere të veçanta:

1. Të jetë i/e thjeshtë, i/e aftë të komunikojë me korrektësi dhe etikë qytetare me personelin e Muzeut të Shkencave të Natyrës dhe vizitorët.
2. Të respektojë me përgjegjësi orarin dhe disiplinën në punë.
3. Të ketë mbrojtur një gjuhë të huaj perëndimore dhe të jetë i/e aftë të komunikojë mirë në këtë gjuhë, preferohet gjuha angleze.
4. Të njohë programet kompjuterike bazë të paketës Microsoft Office
5. Të ketë eksperiencë pune/trajnime, certifikime në sistemet e menaxhimit në funksionimin e laboratorëve.
6. Të jetë e/i motivuar për të ndihmuar në punën kërkimore në laborator dhe në terren.

Kandidatet konkurrentë duhet të dorëzojnë pranë Degës së Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës, këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim.
2. Curriculum vitae.
3. Diplome dhe lilstë notash të studimeve universitare (fotokopje e noterizuar). Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noterizuar e certifikatës së njohjes nga organi kompetent.
4. Dëshmi të njohjes dhe përdorimit të cdo certifikate apo deshmie kualifikimi që kanë (fotokopje e noterizuar).
5. Dëshmi të njohjes të një gjuhe të huaj (fotokopje e noterizuar).
6. Të paktën një referencë nga punëdhënësi i fundit.
7. Dëshmi penaliteti.

8. Dokument identifikimi.
9. Kopje të librezës së punës dhe të librezës së kontributeve të sigurimeve shoqërorë.
10. Raport mjekësor për aftësi në punë.

Dokumentat pranohen pranë Degës së Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të UT-se nga data 12.07.2021-26.07.2021.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

## **UNIVERSITETI I TIRANËS FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS**

### **Njoftim për vend të lire pune**

Fakulteti i Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës shpall një vend të lirë pune si personel ndihmës akademik me karakter administrativ, me detyrë ‘ Specialist I Keshillimit të Karrieres’, me kriteret si më poshtë;

Kiteret e përgjithshme që duhet të plotesojnë kandidatët;

1. Të jetë shtetas shqipëtar me zotësi të plotë për të vepruar.
2. Të ketë përfunduar studimet Bachelor dhe Master Shkencor ose diploma ekuivalente me to.
3. Të njohet me deshmi, disa nga programet baze kompjuterike (Word, Excel, etj).
4. Të mos jetë i/e denuar me vendim të formës së prerë nga gjykata, për kryerjen e një veprë penale me dashje.
5. Të mos jete marre ndaj tij/saj masa disiplinore të largimit nga puna .

Kriteret e veçanta

- 1- Të ketë njohuri të mira të gjuhës Angleze dhe ta ketë të certifikuar atë, sipas kriterëve të MASR.
- 2- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.
- 3- Preferohet të ketë mbaruar studimet në një nga programet e studimit të Universitetit të Tiranës ose në Universitetet e BE –se, OECD ose G-20.
- 4- Preferohet të ketë experience pune në fushën e mardhenieve me studentet si karriere, Alumni etj, në IAL.

Dokumentat që duhet të dorëzojnë aplikantët;

1. Kërkesë e aplikantit, për vendin e punës për të cilin kërkon të konkurojë.
2. Curriculum Vitae
3. Diplome të studimeve universitare (bachelor + master) ose ( sist.4-vjeçar), të noterizuar.
4. Liste notash të studimeve bachelor dhe studimeve master shkencor ,të noterizuar ose liste notash të studimeve 4-vjeçare të noterizuar.
5. Në rastin e diplomave të marra jashtë shtetit, vërtetimin e njehsimit nga MASR.( të noterizuar)
6. Certifikate kompjuteri të noterizuar.
7. Çertifikate të gjuhës së huaj të noterizuar.
8. Kopje të kartës së ID/ose pasaportës.
9. Librezë e punës /në rast se ka qenë i/e punësuar me parë në sektorin publik apo privat.
10. Deshmi e penalitetit